



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 18.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, në mbledhjen e tij të datës 18 shkurt 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Robert Bitri.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Z. Bledi Çuçi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj Ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë rregullat për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, si dhe detyrat e kompetencat e organeve përgjegjëse për zbatimin e tij.

Projektligji është hartuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Politikat e skemave të cilësisë kanë si qëllim mbrojtjen e emrit të një produkti specifik për të promovuar karakteristikat unike të tij, të cilat lidhen me origjinën gjeografike të këtij produkti.

Këto skema janë bërë të domosdoshme pasi:

- Qytetarët dhe konsumatorët kërkojnë gjithnjë e më shumë edhe cilësi përveç ushqimit tradicional;
- Prodhuesit mund të vazhdojnë të prodhojnë një produkt cilësor vetëm nëse ata shëprblehen siç duhet për përpjekjen e tyre;
- Përdorimi i këtyre skemave për prodhuesit, si shpërblim për prodhimin e një game produktesh me cilësi, nxit ekonominë rurale. Sidomos në zonat më pak të favorizuara siç janë ato maloret, si dhe në shumë rajone ku sektori bujqësor zë një vend të rëndësishëm në ekonomi dhe kostot e prodhimit të këtyre produkteve janë të larta;

Me anën e këtij projektligji propozohet hartimi i një baze për vlerësimin dhe regjistrimin e Specialiteteve Tradicionale të Garantuar, për vlerësimin e Emërtimeve të Origjinës dhe Treguesve Gjeografikë, si dhe vlerësimin dhe regjistrimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që nuk janë pjesë e tre skemave, por që plotësojnë kushtet që lidhen me karakterin specifik të prodhimit, traditës etj. Të gjitha produktet bujqësore dhe ushqimore të cilat ofrojnë karakteristika të veçanta tradicionale dhe vlerë të shtuar në mënyrën e prodhimit/përpunimit të tyre, do të regjistrohen si emërtime cilësie STG, EOM dhe TGJM ose skema të tjera cilësie.

Projektligji do të zbatohet për produkte bujqësore dhe ushqimore për konsum njerëzor, që do të përcaktohen sipas listës që do të miratohet me urdhër të Ministrit.

Përfituesit kryesorë të miratimit të këtij projektligji janë konsumatorët dhe grupet e prodhuesve që punojnë me produktet bujqësore dhe ushqimore.

Përparësitë kryesore të projektligjit synojnë të:

- ndihmojnë prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore të reklamojnë cilësinë e produkteve të tyre te konsumatorët;
- sigurojnë konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë;
- japin informacionin e nevojshëm për konsumatorin për cilësinë e këtyre produkteve dhe për të siguruar integritetin e tregut;
- kryejnë vlerësimin në substancë të EO-ve dhe TGJ-ve për produktet bujqësore dhe ushqimore;
- mundësojnë hartimin dhe publikimin e regjistrimit për STG-të dhe produktet, pjesë të skemave të tjera të cilësisë;
- rrisin kërkesën në drejtim të cilësisë së produkteve tradicionale dhe shumëllojshmërisë së prodhimeve bujqësore;
- nxisin zhvillimin e zonave më pak të zhvilluara dhe zonave malore.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 38 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis Communautaire***

Ky projektligj përafron pjesërisht rregulloren e BE-së, nr.1151/2012, “Për Skemat e Cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, si dhe plotëson detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, nenet: 176, 178, 182/c dhe 182/ç.

- ***Efektet financiare të projektligjit***

Projektligji parashikon efekte financiare, të cilat llogariten afërsisht, 3.1 milionë lekë/vit, ndërkohë që të ardhurat do të arrijnë dyfishin e tyre.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që projektligji përcakton rregullat për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, si dhe siguron konkurrencë të drejtë për fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan elementët kryesor që ky projektligj sjell, dhe efektet pozitive që do të sjellë ky projektligj për konsumatorët dhe grupet e prodhuesve që punojnë me produktet bujqësore dhe ushqimore.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në çështjet që lidhen me konsultimin me grupet e interesit; trajnimin e personave që do merren me zbatimin e këtij projektligji; ndërveprimin e mundshëm të këtij projektligji dhe strukturave që ngrihen për zbatimin e tij me parashikimet dhe strukturat e ligjit në fuqi për pronësinë industriale; kapacitetet e AKU-së për mbulimin e kësaj fushe në të gjithë vendin; mundësinë e krijimit të një liste me produktet tipike tradicionale; kontributin e Universitetit Bujqësor në këtë fushë; etj.

- ***Ndryshime të projektligjit***

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni u njoh me raportin e Komisionit për Integrimin European dhe vërejtjet e paraqitura në të, të cilat i bën pjesë të këtij raporti si më poshtë:

Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) Nr. 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 Nëntor 2012 “Mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32012R1151, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.343, datë 14.12.2012, faqe 1-29”.

2. Në nenin 18, pika 1 të riformulohet si më poshtë:

“1. Çdo person fizik ose juridik shqiptar, që ka një interes ligjor për të paraqitur një kundërshtim lidhur me kërkesën për regjistrim të emërimit STG ose ndryshim të specifikimeve për emërtimin STG për produktet bujqësore ose ushqimore, në përputhje me legjislacionin evropian për skemat e cilësisë, njofton ministrinë me shkrim, brenda 2 muajve, nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian”.

3. Pika 2 e nenit 23 të projektligjit, të riformulohet si vijon:

“2. Trupa certifikuese miratohet nëse është e akredituar në përputhje me Standardin Evropian EN 45011 ose ISO/IEC17065, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e akreditimit.”

• ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për integrimin në tregun evropian të bujqësisë shqiptare, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë tek fermerët dhe prodhuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore me karakteristika dhe tregues të vlerës së shtuar të cilësisë .

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

Robert BITRI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar